

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sektori - Blegtorët në vështirësi pa ndihmë nga shteti, i drejtohen qeverisë me 7 kërkesa - Nga akciza, nafta ...
ADRESA	https://www.syri.net/ekonomi/919833/blegtoret-ne-veshtiresi-pa-ndihme-nga-shteti-i-drejt-ohen-qeverise-me-7-kerkesa-nga-akciza-nafta-dhe-rialokimi-i-fondeve/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 07:41:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 06:19:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f9add3c03074eeb57a96175f0fe9bb3736f78327ee5960f9bceafa4ff7a0bcd5
TEKSTI	5e729873c3977fc097042323e2f5e2319681ce9f8042d612c5ab80609563ec08
PAMJA	4b9e6bcfb51ec1b12b69d268b1a5acc4ca68974673c3c0eed620b65898bf2552

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6d8ccc9416170235cd340bc6367f07990f9bdeb25306ba64de2357540aac11b
E MËPARSHMJA	488a7758971887cb2bc8ff6a768c72233e810904784d283b2024205dba6c9135
RRËNJA MERKLE	00c036a8b9d029228ae2ceb40f7ad3139dd1ddd4285277109f3fa37fa73abd7e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6d8ccc9416170235cd340bc6367f07990f9bdeb25306ba64de2357540aac11b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**GENC POLLO**

Dy Edi Ramat në Nju Jork dhe raporti i sikletshëm me të tashmen e të shkuarën

**KIM MEHMETI**

Piktori do të lërë emër në histori, por si 'kreu i qelbësirave' dhe antishqiptar i përbetuar!

**më të lexuarat**

Blegtorët në vështirësi pa ndihmë nga shteti, i drejtohen qeverisë me 7 kërkesa - Nga akciza, nafta ...

Ndalimi i importeve të mishit nga Brazili, përpunuesit paralajmërojnë rritje të çmimeve deri në 40%

Këmbimi valutor 28 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro

Këmbimi valutor 27 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera

Dështimi/ Turizmi ngadalëson rritjen

Kriza e karburanteve në Itali: Qeveria nën presion, Siçilia paralajmëron ndalimin e transportit

Blegtorët në vështirësi pa ndihmë nga shteti, i drejtohen qeverisë me 7 kërkesa - Nga akciza, nafta ...

08:19, 29/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Sektori i blegtorisë gjendet në vështirësi, për shkak të kostove të larta dhe subvencioneve të ulëta. Përfaqësues të sektorit rikthejnë në vëmendje nisjen e protestave nëse nga institucionet nuk do të plotësohen kërkesat e tyre.

Disa blegtorë prodhues përfaqësues për sektorin, tashmë i janë drejtuar me një letër kryeministrit Edi Rama, ministrit të Bujqësisë Andis Salla dhe ministrit të Financave Petrit Malaj, duke kërkuar ndërhyrje të menjëhershme për situatën e sektorit të qumështit.

Në letërën e tyre, blegtorët shprehën se sektori ndodhet në kushte të vështira dhe se nevoja për zgjidhjen e problematikave është bërë gjithnjë e më emergjente.

Blegtorët kujtojnë dakordësimin e bërë në takimin e 7 prillit 2026 me ministrat e Bujqësisë dhe të Financave, kur sipas tyre ishte rënë dakord që çështjet e sektorit të trajtoheshin në muajin shtator. Por, sipas blegtorëve, situata e tregut nuk lejon më shtyrjen e zgjidhjeve.

"Aktualisht blegtorët janë në kushte të vështira mbijetese dhe nevoja për zgjidhjen e kërkesave tona bëhet përditë edhe më emergjente. Kemi pritur Shtatorin sipas dakordësimit të bërë në takimin e datës 07.04.2026, por kjo pritje nuk mund të shtyhet më tej. E rrjedhur kjo nga problematikat që janë të njohura, por dhe ato të pa parashikuara që ndodhet sot tregu në Shqipëri", theksohet në letërën e tyre.

Blegtorët rendisin 7 kërkesa konkrete për plotësim ndaj qeverisë. Një nga kërkesat kryesore të përfaqësuesve të sektorit lidhet me uljen e kostove të prodhimit përmes heqjes së akcizës dhe taksave mbi naftën për sektorin e blegtorisë.

Kjo kërkesë ishte edhe në qendër të protestave të fermerëve të zhvilluara në fillimin e muajit prill, të cilët kanë kërkuar rikthimin e skemës së naftës së subvencionuar. Heqja e skemës së naftës erdhi në një periudhë kur çmimet e karburanteve dhe të inputeve bujqësore pësuan rritje të konsiderueshme, duke çuar në rritjen e çmimit të produkteve të blegtorisë.

Shkollë profesionale me formim për shpirtësi dhe profesionalitet.

Qindra fermerë në protestë, kërkojnë rikthimin e skemës së naftës dhe rritje të subvencioneve

Një tjetër kërkesë konkrete financiare është që pjesa e fondeve të përcaktuara nga skema për kompensimin 10% të TVSH-së të rialokohet për subvencionimin e blegtorëve.

Pra blegtorët prodhues kërkojnë që fondet e parashikuara për dhënien e kompensimit të TVSH-së 10%, por të papërdorura, të orientohen drejt mbështetjes së sektorit të blegtorisë.

Aplikimet për kompensimin e TVSH-së 10% kanë nisur nga 1 korriku. Efekti financiar në vitin e parë të zbatimit llogaritet rreth 1.5 mld lekë apo rreth 15 mln euro. Nga blegtorët është përsëritur disa herë se skema e kompensimit nuk pritet të jetë efikase, pasi masa e kompensimit përcaktohet në bazë të autofaturave të lëshuara prej grumbulluesve për blerjet e bëra të fermerët dhe blegtorët, që në shumë raste i lëshojnë me vlera që iu shërbejnë atyre për rregullimin e balanceve.

Kompensimi 10% i TVSH-së, Shoqata e Blegtorëve ngre shqetësimin për mosdhënien e autofaturave

Një tjetër kërkesë është rishikimi i skemave ekzistuese të mbështetjes dhe shtimi i subvencioneve për blegtorët. Sipas prodhuesve, niveli aktual i mbështetjes nuk mjafton për të përballuar kostot dhe vështirësitë me të cilat përballlet sektori.

Kërkesa të tjera të tyre janë është krijimi i një laboratorit shtetëror për kryerjen e analizave të qumështit, rikthimin e tarifave për importin e qumështit pluhur, vajit të palmës.

Blegtorët kërkojnë që nga institucionet të forcohet kontrolli për qumështin e importit për përmbajtje të lëndëve të ndaluara. Ndërsa për ta problem mbetet edhe përmbajtja e etiketave të prodhimeve të produkteve të bulmetit, për rastet kur për prodhim vendas përdoret qumësht i importit.

Edhe më herët përfaqësues të blegtorëve ngritën për Monitor shqetësimin e vështirësive që po has sektori dhe paralajmëruan rikthimin e protestave në fillim të muajit shtator, nëse kërkesat e tyre nuk merren parasysh nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Fermerët paralajmërojnë rikthimin e protestave në shtator, duan naftë pa akcizë dhe subvencione

Kërkesat e blegtorëve prodhues

Krijimi i një laboratorit shtetëror për analizat e qumështit;

Uljen e çmimit të naftës për blegtorët duke hequr akcizën dhe taksat;

Vendosjen e tarifave për produktet e vajit të palmës, qumështit pluhur dhe hirrës;

Rishikimin dhe shtimin e subvencioneve të dhëna ndaj blegtorëve;

Etiketimi i produkteve duke treguar vendin e origjinës së qumështit me të cilin prodhohet;

Rialokimin e pjesës së përcaktuar nga skema e 10% në subvencione për blegtorët;

Kontrolle në kufi për qumështin e importit për aflatoksinë, proteinë, yndyrë dhe ngarkesë mikrobiologjike.

"Kërkesat e sipërcituara janë jetike për situatën ku ndodhet aktualisht sektori i blegtorisë dhe rrjedhimisht kërkojmë një takim të përbashkët me të dy Ministrinë sa më parë që të jetë e mundur pasi çdo ditë e më tepër po vështirësohet mbijetesa e këtij sektori", theksojnë blegtorët në letrën e tyre. / Monitor.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Ndalimi i importeve të mishit nga Brazili, përpunuesit paralajmërojnë rritje të çmimeve deri në 40%



Kriza e karburanteve në Itali: Qeveria nën presion, Siçilia paralajmëron ndalimin e transportit



Pasqyrë moj pasqyrë! Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta

Këmbimi valutor 26 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera



Shqipëria ndër më të shtrenjtat në rajon për të ngrënë një vakt jashtë



Si po shuhet prodhimi/ Industria e veshjeve dhe këpucëve po kalon krizën më të thellë në histori

TË NGJASHME



Dështimi/ Turizmi ngadalëson rritjen



Këmbimi valutor 27 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera



Si po shuhet prodhimi/ Industria e veshjeve dhe këpucëve po kalon krizën më të thellë në histori



Shqipëria ndër më të shtrenjtat në rajon për të ngrënë një vakt jashtë



Këmbimi valutor 26 shtator/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera



dev.al dhe Pago prezantojnë risitë e vitit: nga arka e dyqanit te pagesa, drejt një ekosistemi të vetëm



SYRI TV/ Zhvlerësimi i euros fut në krizë manifakturën, prodhuesit: Qeveria të marrë masa fiskale

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.